



## **SPECIFIKIME TEKNIKE OBJEKTI "RIKONSTRUKSION KANALI UJITËS DHE TUB SIFONI DEGËZIMI BËRSNIK SIPËR - MASHAN NJ.A.KODOVJAT BASHKIA GRAMSH.**

Për realizimin në kohë, me cilësi të mirë dhe në përputhje me kërkesat kontratës së sipërmarjes të punimeve në obektin Rikonstruksion kanali ujites dhe tub sifoni degëzimi Bërsnik Sipër - Mashan, është e nevojeshme të kihen parasysh edhe disa specifikime teknike të përshkruara si më poshtë.

### Të përgjithshme

Punimet për zëvendësimin e tubacionit prej celiku Ø 400, do të kryhen në një terren të pjerrët që varion nga 40% deri në 60%. Gjatësia e tubacionit që zëvendësohet është gjithsej rrëth 120 ml kryesisht në anën veriore i segmentit të sifonit Nr 1 dhe në anën jugore segmentit të sifonit Nr. 2 sipas projektit fillestardhe punimet e gërmimit do të bëhen në formacion flishor me fortësi mesatare në spërfaqe. Tubacioni në këtë segment do të mbështet e fiksohet nëpër jastëk betoni C 16/20.

### Zëvendësimet

Zëvendësimi i materialeve të specifikuara në Dokumentin e Kontratës do të bëhet vetëm me aprovin e Mbikëqyrësit të Punimeve nëse materiali i propozuar për tu zëvendësuar është i njëjtë ose më i mirë se materialet e specifikuara; ose nëse materialet e specifikuara nuk mund të sillen në sheshin e ndërtimit në kohë për të përfunduar punimet e Kontratës për shkak të kushteve jashtë kontrollit të Sipërmarrësit. Që kjo të merret në konsideratë, kërkesa për zëvendësim do të shoqërohet me një dokument dëshmi të cilësisë, në formën e kuotimit të çertifikuar dhe të datës së garancisë të dorëzimit nga furnizuesit e të dy materialeve, si të materialit të specifikuar ashtu edhe të atij që propozohet të ndryshohet.

### Kostot e Sipërmarrësit për mobilizim dhe punime të përkohëshme

Do te kihet parasysh që Sipërmarrësit nuk do t'i bëhet asnjë pagesë mbi çmimet njësi të kuotuara për kostot e mobilizimit, d.m.th. për sigurimin e transportit, veglat dhe pajisjet, ose për furnizimin e ndertimin e rrugëve të hyrjes, heqjen e mbeturinave, bangot e punës, rojet, si dhe struktura të tjera të përkohëshme, pajisje dhe materiale, ose për kujdesin mjekësor dhe mbrojtjen e shëndetit, ose për ndonjë shërbim tjetër, lehtësi, gjëra, ose materiale të nevojshme ose që kërkohen për zbatimin e punimeve në përputhje me atë që është parashikuar në Kontratë.

### Hyrja në sheshin e ndërtimit

Sipërmarrësi duhet të organizojë punën për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe më pas të spostojë dhe ta rivendosë çdo rrugë hyrje që do të duhet në lidhje me zbatimin e punimeve. Çvendosja do të përfshijë përshtatjen e zonës me çdo rruge hyrje të njëjtë me atë që ekzistonte përpëra se Sipërmarrësi të hynte në Shesh.

### Piketimi i punimeve

Sipërmarrësi, me shpenzimet e tij duhet të bëjë ndërtimin e modinave dhe të piketave siç kërkohet, në përputhje me informacionin bazë të Punëdhënësit, dhe do të jetë perjegjësi i vetëm për përpikmërinë.

### Fotografitë e sheshit të ndërtimit

Sipërmarrësi duhet të bëjë fotografi me ngjyra sipas udhëzimeve të Mbikqyrësit të Punimeve në vendet e punës për të demostrar kushtet e sheshit përpëra fillimit, progresin gjatë punës së ndërtimit dhe mbas përfundimit të punimeve.

Nuk do të bëhen pagesa për fotografimin e kantierit të punimeve pasi këto shpenzime janë parashikuar të mbulohen nën koston administartive të Sipërmarrësit.

#### Bashkëpunimi në zonë

Ndërtimi do të bëhet në zona të kufizuara. Sipërmarrësi duhet të ketë veçanërisht kujdes në:

a) nevojën për të mirëmbajtur shërbimet ekzistuese dhe mundësitë e kalimit për banorët dhe tregëtarët që janë në zonë, gjatë periudhës së ndërtimit.

b) prezencën e mundëshme të kontraktorëve të tjera në zonë me të cilët do të koordinohet puna

E gjithë puna, do të bëhet në një mënyre të tillë, që të lejojë hyrjen dhe përballimin e të gjithë pajisjeve të mundëshme për ndonjë Kontraktor tjetër dhe punëtorëve të tij, stafin e Punëdhënësit si edhe të çdo punonjësi që mund të punësohet në zbatim dhe, ose punimet në zonë ose pranë saj, për çdo objekt që ka lidhje me Kontratën ose çdo gjë tjetër.

#### Mbrojtja e punës dhe e publikut

Sipërmarrësi do të marrë masa paraprake për mbrojtjen e punëtorëve të punësuar dhë të jetës publike, si edhe të pasurive në dhe rreth sheshit të ndërtimit. Masat e sigurimit paraprak të ligjeve të aplikushme, kodeve të ndërtesave dhe të ndërtimit do të respektohen duke punuar rregulloren e sigurimit teknik për punimet konkrete në terren si dhe për manovratorët për makineritë, pajisjet veglat, mjetet dhe çdo rrezik të mundëshëm të cilët do të kqyren ose eliminohen në përputhje me masat paraprake të sigurimit.

Gjatë zbatimit të punimeve Sipërmarrësi, me shpenzimet e veta, duhet të vendosi dhe të mirëmbajë gjatë natës pengesa të tillë dhe drita të cilat do të parandalojnë në mënyrë efektive aksidentet. Sipërmarrësi duhet të sigurojë pengesa të përshtatëshme, shenja me dritë të kuqe "rrezik" ose "kujdes" dhe vrojtues në të gjitha vendet ku punimet mund të shkaktojnë çrregullime të trafikut normal ose që përbëjnë në ndonjë mënyrë rrezik për publikun.

#### Mbrojtja e ambjentit

Sipërmarrësi, me shpenzimet e veta, duhet të ndërmarrë të gjithë veprimet e mundëshme për të siguruar që ambjenti lokal i sheshit të ruhet dhe që vijat e ujtit, toka dhe ajri (duke përfshirë edhe zhurmat) të jenë të pastra nga ndotja për shkak të punimeve të kryera. Mos plotësimi i kësaj klauzole, në bazë të evidentimit, mund të çojë në ndërprerjen e kontratës.

#### Transporti dhe magazinimi i materialev

Transporti i çdo materiali nga Sipërmarrësi, do të bëhet me automjete të përshtatëshme, që nuk shkaktojnë derdhje dhe e gjithë ngarkesa të jetë e siguruar. Të gjitha materialet që sillen nga Sipërmarrësi, duhet të stivohen ose të magazinoohen në mënyrë të përshtatëshme për t'i mbrojtur nga rrëshqitjet, dëmtimet, thyerjet, vjedhjet dhe në dispozicion, për tu kontrolluar në çdo kohë.

#### Sheshi për magazinim

Sipërmarrësi duhet të bëjë me shpenzimet e tij, marrjen me qira ose blerjen e një terreni të mjaftueshëm për ngritjen e magazinave me shpenzimet e tij.

#### Pastrimi përfundimtar i zonës

Në përfundim të punës, sa herë që është e aplikueshme Sipërmarrësi, me shpenzimet e tij, duhet të pastrojë dhe të heqë nga sheshi të gjitha materialet që kanë tepruar, mbeturinat, skeleritë dhe ndërtimet e përkohëshme të çdo lloji dhe të lërë sheshin e lirë dhe veprat të pastra dhe në kondita të pranueshme.

Pagesa përfundimtare e Kontratës do të mbahet deri sa kjo të realizohet në përputhje të plotë me kërkesat e përcaktuara dhe pasi të jepet miratimi përkatës sipas ligjeve në fuqi.

## Punime dheu.

Ky seksion përban përcaktimet e përgjithshme dhe kërkesat për punimet e gërmimeve në tokë për struktura në themele, përfshirë gërmim në prezence uji etje.

Gërmimi në dhera duhet të aplikohet në të gjitha materialet që mund të gërmohen si me krahë, (përfshi me kazma lopata etje.) ashtu dhe me makineri.

Të gjitha zërat e gërmimeve do të maten në volum. Matja e volumit të gërmimeve do të bazohet në dimensionet e marra nga vizatimet, në të cilat përcaktohen përmasat e gërmimeve.

Megjithatë, nëse gërmimi është më pak se volumi i llogaritur, do të paguhet volumi faktik i gërmimeve sipas matjeve faktike.

Çmimi njësi për gërmimi mbalon shpenzimet e fuqisë punëtore dhe çdo aktivitet tjeter përshkruar më sipër të cilat janë të domosdoshme për ekzekutimin e punimeve per  $1\text{m}^3$  dhei te germuar e te matur ne objekt të bazuar në përmasat e nxjerra nga vizatimet që lidhen me këtë proces.

### Për zërin “ Prerje pemë të vogla deri $\varnothing 10-20\text{cm}$ ”

Në cmim përfshihen shpenzimet e punëtorisë për prerjen e pemëve dhe shkurreve në trase e skrapatat e kanalit.

Çmimi për 1 cop peme, shkure me  $d=10-20\text{cm}$  të prera e të matura në objekt.

### Për zërin “ Gërmim dhei me krahë e makineri në kanale,bazamente,rrugë etj.

Në cmim përfshihen shpenzimet e punëtorisë për gërmimet me krahë të tokës dhe hedhjen e dherave të gërmuara jashtë kanalit, ndërsa gërmim dhera me makineri në preventiv parashikohet zë i vecante i cili përfshin edhe shpenzimet e makinerisë.

Çmimi është për  $1\text{m}^3$  dhe të gërmuar e matur në objekt.

Për zërin “ Struktura monolite betoni C-16/20“ bëhet fjalë për element betoni si ;bazamente blloqe apo themele plinta nën konstruksionet mbajtëse për fiksimin e tubacioneve. kokat e tubacioneve etje.të cilat do të përdoren për vazhdimesinë e kanalit në kalimin e përenjeve.

Në cmim përfshihen shpenzimet e puntorisë, blerjen e materialeve,pregatitjen dhe hedhjen e betonit në kallëpe ngjeshjen e tyre në vendet ku ato janë parashikuara në projekt si dhe dizarmimin e tyre pas ngurtësimit të tij në vepër. Betoni do të jetë i markës C 16/20, i preqatitur me rërë të larë e zall të larë lavatriceje dhe cemento të M – 400 ( 42.5 R ).

Çmimi për  $1\text{m}^3$  beton të hedhur e vendosur në vepër dhe të matur në vend.

### Për zërin “Furnizim vendosje detaje metalike në betonarme”

Në cmim përfshihen shpenzimet e punëtorisë për preqatitjen,vendosjen nëpër vendet e përcaktuara në projekt,si hekur betoni,pllaka celiku, blerjen e materialeve profile metalike, realizimin e saldimeve, harxhimin energjisë elektirike në objekt,elektrodave për saldim të elementeve fiksues të tubacioneve pas patrimit të ndryshkut (kur ka nevojë) nëpërmjet saldimit të elementave prej celiku apo tubacioneve me përmasa sipas përshkrimit në projekt.

Çmimi është për 1 ton hekur betoni apo pllaka metalike celiku të salduara + elektroda e të vendosura në vendet e përcaktuara me projekt në objekt.

**Për zërin " Furnizim vendosje tuba celiku të zi  $\varnothing 400$  t=6.3mm"**

Në cmim përfshihen shpenzimet e punëtorisë, blerjen e materialeve, harxhimin e elektrodave ose energjisë elektrike, vendosjen me mjete të thjeshta e makineri të tubacioneve në vendet e përcaktuara në projekt etje procese të nevojeshme për realizimin e saldimeve në objekt. Tubacioni do të jetë celiku të zi  $\varnothing 400$  me spresor 6.3 mm.

Cmimi është për 1 ton tubacion të vendsour në objekt.

**Për zërin Lyerje tubacioni me dy duar bitum**

Në cmim përfshihen shpenzimet e punëtorisë për blerjen e materileve, marjen nga magazina pregetitja e tyre për ti vendosur në objekt, lyerja e tubacionit të celikut me dy duar bitum tip prajmer etje. Cmimi është për një m<sup>2</sup> tubacion të lyer me dy duar bitum dhe të matur në vend në object

Këto ishin disa specifikime që menduan të specifikojmë për disa nga zërat më kryesore të punimeve që do të kryhen në dy sektorë të dëmtuar të kanalit, në degëzimin Bërsnik Sipër – Mashan.

Për cdo paqartësi apo sqarime më të detajuara të kontaktohet me njësinë e prokurimit pranë Bashkisë Gramsh.

Punoi: **Ing. Dhori Nishku**

